



Pranuar / Dateduar Compend / Prodato Received / Uchytuar	14.06	2022	2	viti god year
Organ / Shkronja Organ / Jednoca Org. / Abnt	SKM/SHCK	3475/2022		115

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.393/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi- Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.393/2022 të datës 19.04.2022 me numër protokollit 2191/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga kundër Vendimit me nr.Ref.BD-161/1 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.06.2022, mori këtë.

V E N D I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.393/2022 e parashtruar me datë 19.04.2022 nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimit me nr.Ref.BD-161/1 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 14.04.2022.
- III. **MBETET në fuqi** Raportit përfundimtar i Komisionit të Pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën „Drejtor Menaxhues i AKP-së” i datës 08.04.2022.
- IV. **OBLIGOHET** Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të bëjë zbatimin e këtij vendim brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, njëkohësisht **obligohet** që të përzgjedh dhe emërojë njërin nga kandidatët e propozuar nga Komisionin i Pranimit për pozitën e “Drejtorit Menaxhues të AKP-së”.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokollit: AE/11/1/2013 të datës 03.12.2013 i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit në pozitën “Drejtor i Departamentit të Administratës” me datë 19.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2191/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Vendimi me nr.Ref.BD-161/1 i Bordit të Drejtorëve të

Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për anulimin e konkursit për pozitën “Drejtor Menaxhues i AKP-së” me arsyetimin se vendimi i tillë është pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me ligjin material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 26.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa kjo e fundit me datë 12.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2737/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë dhe nevojës për shqyrtime shtesë dhe sqarime të mëtejme të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe për shkak të volumit të lëndës dhe kompleksitetit të saj, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit me datë 02.06.2022 ka nxjerre vendimin me numër:49/2022 për shtyrjen e afatit të vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë-ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokollit 2191/2022 të datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 15.12.2021; Njoftimin e datës 03.02.2022 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Njoftimin e datës 09.02.2022 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Njoftimin e datës 23.02.2022 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Shkresën me njoftimet e vlerësimit të fazave të konkurrimit; E-mailin e datës 15.04.2022 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkëngjitur; Njoftimin e lajmit të publikuar në portalin telegrafi.com; E-mailin e datës 15.04.2022 dërguar nga ankuesin; Vendimit me nr.Ref.BD-161/1 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Vendimin me numër:49/2022 i Kryetarit të Këshillit i datës 02.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 26.04.2022; E-mailin e datës 06.06.2022 me kërkesën e bashkëngjitur të ankuesit dërguar në Këshill; Përgjigje në ankesë e datës 12.05.2022; Vendim me nr. Ref. BD-155/3 i datës 06.12.2021; Konkursi me nr. reference RN00007978 i datës 15.12.2021; Vendim i datës 14.02.2022; Lista e aplikantëve SIMBNJ; Lista e aplikantëve simbnj; Njoftim i datës 03.02.2022; Njoftim i datës 09.02.2022; Aplikacioni i M.A. i datës 27.01.2022; Certifikatë e M.A. e datës 12.01.2022; Letërnjoftim i M.A.; Licencë e M.A. me nr.1/2021 e datës 07.06.2021; Diplomë e M.A. me nr. 28/10 i datës 16.11.2010; Diplomë e M.A. me nr. 57 i datës 12.12.2007; Letër motivuese e M.A.; Referencë e datës 07.10.2005; Referencë e datës 12.06.2008; Vërtetim mbi përvojën e punës për M.A. i datës 18.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për M.A. i datës 23.02.2021; Plani individual i trajnimit i datës 23.02.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për M.A. i datës 23.02.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për M.A. i datës 24.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për M.A. i datës 24.01.2022; Plani individual i trajnimit i datës 24.01.2022; Aplikacioni i B.S. i datës 27.01.2022; Akt Emërim i B.S. i datës 01.10.2021; Akt Emërim i B.S. i datës 03.12.2013; CV-ja e B.S. Diplomë e B.S. me nr. 3005 i datës 23.03.2017; Diplomë e B.S. me nr. protokollit 192/541-978/33 i datës 09.10.1999; Diplomë e B.S. me nr. 04/2017 i datës 21.04.2017; Certifikatë e B.S. i datës 27.10.2021; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e B.S. i datës 06.03.2006; Kontratë për punësim në kohë të caktuar e B.S. e datës 28.06.2004; Vendim me nr. protokollit 13/2021 i datës 05.10.2021; Vendim me nr. protokollit 09/2016 i datës 22.04.2016; Vendim me nr. protokollit 162/2016 i datës 30.08.2013; Vendim me nr. protokollit 04/2013 i datës 03.01.2013; Vendim për autorizim me nr 01-13 i datës 18.07.2012; Vendim me nr. 18/2011 i datës 01.08.2011; Kërkesë me nr.08/2011 e datës 06.07.2011; Marrëveshje e datës 28.07.2011; Kontratë e Marrëdhënies së punës e B.S. e datës 30.04.2011; Vendim me nr. protokollit 1201/2009 i datës 05.05.2009; Raport me nr. protokollit 1210/09 i datës 17.06.2009; Letërnjoftim i B.S.; Pasaporta e B.S.; Letër motivimi i B.S. i datës 27.01.2021; Letër rekomandimi për B.S. i datës 01.04.2009; Letër rekomandim për B.S. i datës 05.11.2021; Letër falënderimi për B.S. i datës 16.05.2006; Mirënjohje për B.S. i datës 29.12.2006; Mirënjohje për B.S. i datës 31.12.2007; Vendim për B.S. i datës 11.01.2007; Vendim për themelimin e komitetit

të auditimit të brendshëm i datës 27.08.2008; Vendim për B.S. i datës 26.08.2008; Certifikatë e B.S. i datës 15.10.2006; Certifikatë e B.S. i datës 30.04.2006; Certifikatë e B.S. i datës 22.09.2013; Certifikatë e B.S. i datës 14.04.2013; Certifikatë e B.S. i datës 25.10.2009; Certifikatë e B.S. i datës 27.08.2012; Certifikatë e B.S. i datës 29.04.2016; Certifikatë e B.S. i datës 01.04.2015; Certifikatë e B.S. iso 27001; Certifikatë e B.S. i datës 25.06.2015; Certifikatë e B.S. i datës 18.03.2009; Certifikatë e B.S. i datës 18.05.2012; Certifikatë e B.S. i datës 17.07.2016; Certifikatë e B.S. i datës 31.07.2016; Certifikatë e B.S. i datës 07.05.2000; Certifikatë e B.S. i datës 05.12.2009; Certifikatë e B.S. i datës 12.12.2008; Certifikatë e B.S. i datës 27.06.2008; Vërtetim mbi përvojën e punës së nëpunësit B.S. i datës 29.10.2021; Vlerësimi për vitin 2020; Vendim me nr.01-52 i datës 16.06.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për M.A. i datës 24.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për B.S. i datës 25.01.2022; Aplikacioni i A.L. i datës 27.01.2022; Vërtetim mbi punësimin i A.L. i datës 26.01.2022; Certifikatë e A.L. i datës 21.01.2022; Certifikatë e A.L. i datës 02.11.2019; Certifikatë e A.L. i datës 13.06.2014; Certifikatë e A.L. i datës 31.05.2008; Certifikatë e A.L. i datës 14.04.2011; Vendim me nr.216/378 i datës 11.05.2021; Certifikatë e A.L. i datës 22.05.2019; Diplomë me nr.1550 i datës 18.09.2007; Kontratë pune e A.L. i datës 01.12.2017; Kontrata e punës e A.L. e datës 01.01.2009; Aneksi i kontratës së punës i A.L. i datës 22.04.2009; Kontrata e punës e A.L. e datës 11.12.2009; Kontrata e punës e A.L. e datës 11.01.2010; Kontratë e punësimit e A.L. i datës 27.09.2011; Kontrata e punës e A.L. e datës 28.12.2011; Kontrata e punës e A.L. e datës 21.07.2017; Kontrata e punës e A.L. e datës 28.09.2020; Letër motivuese e A.L.; Letërnjoftim i A.L.; Referencë e datës 03.01.2009; Letër rekomandim për A.L. i datës 23.01.2007; Shkresë e datës 26.01.2022; Letër rekomandim për A.L. i datës 16.12.2008; Formulari për vlerësimin e detyrave në punë për A.L. i datës 29.01.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës i A.L. i datës 29.01.2021; Plani individual i trajnimit i datës 29.01.2021; Formulari për vlerësimin e detyrave në punë i A.L. i datës 21.01.2020; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës i A.L. i datës 21.01.2020; Plani individual i trajnimit i datës 21.01.2020; Njoftim i datës 23.02.2022; Pyetjet e hapura për testin individual simbnj kandidati CN0310; Pyetjet e hapura për testin individual simbnj kandidati CN0530; Pyetjet e hapura për testin individual simbnj kandidati CN7735; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 31.03.2022; Ekstrakt nga sistemi elektronik HRMIS; E-mail nga L.XH.T. për M.A. i datës 31.03.2022; Njoftim i datës 31.03.2022; Lista e kandidatëve fitues i datës 01.04.2022; Raporti përfundimtar i Komisionit të Pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues i AKP-së i datës 08.04.2022; Vendim me nr.Ref. BD-161/1 i datës 14.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, mbi bazën e shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 15.12.2021 ka shpallur konkursin për pozitën "Drejtor Menaxhues i AKP-së" e cila sipas shkresave të lëndës hynë në klasifikimin e pozitave të Nivelit të Lartë Drejtues në Shërbimin Civil e përcaktuar me paragrafin 2 neni 33 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë: *"Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme"*.

Po ashtu, Kolegji ka konstatuar se në këtë pozitë ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa sipas Njoftimit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 01.04.2022 respektivisht listës së kandidatëve fitues është konstatuar se i njëjti pas vlerësimit me pikët e përmbledhura nga testi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervista me gojë nga ana e Komisionit të Pranimit është vlerësuar me gjithsejtë 76.3 pikë dhe mbi këtë bazë e ka plotësuar kriterin e nevojshëm për tu vlerësuar si kandidatë në mesin e kandidatëve të suksesshëm, ndërsa sipas Raportit përfundimtar të Komisionit të Pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues i AKP-së i datës 08.04.2022 ankuesi së bashku me kundër kandidatit tjetër A.L me gjithsejtë 79.74 pikë si kandidatë të suksesshëm janë propozuar për emërim tek Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë neni 40 paragrafi 1, 2 dhe 8 ku përcaktohet se: *“Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil. 2. Konkurrimi organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për çdo institucioni tjetër shtetëror (në vijim Njësia e Pranimit); 8. Jo më shumë se tre (3) kandidatët e vlerësuar, nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Me emrat e kandidatëve fitues njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ata bëhen publik nga Njësia e pranimit në ueb faqen unike të procedurave të konkurimit të SIMBNJ-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht dhe kanë të drejtën e ankimit në KPMSHCK, në afat kohor 8 dite kalendarike.”* dhe ka konstatuar se Vendimi me nr.Ref.BD-161/1 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 14.04.2022 përmes të cilit është anuluar procedura e rekrutimit për pozitën “Drejtor Menaxhues” me arsyetimin e dhënë në këtë vendim, citoj: *“... me qëllim që procesi i ardhshëm i rekrutimit të sjellë një numër më të madh të kandidatëve që do të rrisë konkurrencën bordi vendosi sikur në dispozitiv të këtij vendimi”* është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material pasi që sipas Raportit përfundimtar të Komisionit të Pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues i AKP-së i datës 08.04.2022 kanë qenë të propozuar dy (2) kandidatë të suksesshëm me mbi 70 pikë, respektivisht është plotësuar kriteri i përcaktuar sikurse në nenin 40 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë si dhe në nenin 13 paragrafin 6 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“Jo më shumë se tre (3) kandidatë dhe jo më pak se dy (2) kandidatë të vlerësuar nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Në rast të pikëve të barabarta zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e nenit 27 të Rregullores përkatëse për pranim dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës”*.

Kolegji thekson faktin se me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 85 është përcaktuar se: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”*, rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil si në rastin konkret vlejné vetëm dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Andaj, në kuptim të nenin 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”*, Kolegji konstaton se Vendimi me nr.Ref.BD-161/1 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 14.04.2022, është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material respektivisht Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe si rrjedhojë diskrecioni i përdoruar apo e drejta e ushtruar për të anuluar procedurën e rekrutimit është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe të gjeturave të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar, andaj mbi këtë bazë Kolegji e ka shfuqizuar Vendimin me nr.Ref.BD-161/1 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka lënë në fuqi Raportin përfundimtar të Komisionit të Pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues i AKP-së i datës 08.04.2022, ndërsa Agjencia Kosovare e Privatizimit respektivisht Bordi i Drejtorëve obligohet që të vazhdojë me procedurën e rekrutimit respektivisht përzgjedhjen dhe emërimin e njërit nga kandidatët e propozuar nga Komisioni i Pranimit përmes Raportit

përfundimtar të datës 08.04.2022 siç përcaktohet me dispozitat e Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik lidhur me emërimin në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila mendon se vendimi Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.393/2022.

Valentina Kaçandolli
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetarja e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

